



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 2
Prishtinë, më 05.05.2021, në orën 9:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Haki Abazi, Xhavit Haliti, Adelina Grainca, Dimal Basha, Gazmend Gjyshinca, Fitore Pacolli-Dalipi, Ariana Musliu-Shoshi, Time Kadrijaj dhe Bahrim Shabani.

Munguan: Branislav Nikoliq dhe Kujtim Shala.

Në këtë takim ishte i ftuar: z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog.

Pjesëmarrës të tjerë: Arbresha Asllani GP-AAK, Arbenita Mjekiqi Kabineti i Kryetarit të Kuvendit, Arianit Behrami Kuvend, Ermira Gashi Kuvend, Butrint Berisha PIPS, Arber Fetahu GLPS, Eugen Cakolli KDI, Dajana Berisha FIQ/KOSID, Adrian Emini KOSID dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi: Haki Abazi, kryetari i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takim me zëvendëskryeministrin e parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog z. Besnik Bislimi lidhur me vizitën në Bruksel;
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 13 prill 2021;
4. Miratimi i fushëveprimit të komisionit;
5. Shqyrtimi i përfundimit nr. 08-P-007 lidhur me formimin e grupeve të miqësisë;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Takim me zëvendëskryeministrin e parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog z. Besnik Bislimi lidhur me vizitën në Bruksel

Haki Abazi, njoftoi se zëvendëskryeministri Bislimi është ftuar në komision për ta mbajtur në vazhdimësi komisionin dhe Kuvendin të informuar për proceset e rëndësishme nëpër të cilat po kalon Kosova. Dialogu tha se përbën çështjen thelbësore të problematikës me të cilën Kosova është ballafaquar që nga viti 2011 kur është marrë vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ai më tej shtoi se ka mirëkuptim të plotë për kontinuitetin e vështirë që ka ndodhur nëpër faza të ndryshme me mungesën e materialit të detajuar për proceset nëpër të cilat ka kaluar dialogu, si dhe ndryshimet e shpeshta në legjislaturë dhe ekzekutiv. Këto tha se e bëjnë të vështirë që fotografia të jetë e qartë për atë se ku po shkon dhe se si është duke u zhvilluar dinamika në dialogun me Serbinë.

Besnik Bislimi, fillimisht njoftoi se për vizitën në Bruksel ka përgatitur një raport të detajuar me shkrim, të cilin ia ka dërguar Presidentes së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit, Ministres së Punëve të Jashtme, Kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Ai shtoi se arsyeja se pse janë mbajtur këto takime me z. Lajçak, nuk ka të bëjë me dialogun, por se ka pas nevojë që ekipi ynë të informohet në detaje për atë se çfarë ka ndodhur gjatë këtyre viteve në Bruksel me fokusim më të madh në periudhën e Qeverisë Hoti. Ai më tej shtoi se në momentin kur e kemi marrë detyrën si qeveri e re, kemi gjetur pothuajse zero dokumente për dialogun, kjo ka qenë shumë shqetësuese dhe hapi i parë që kemi ndërmarrë ka qenë grumbullimi informacioneve nga burimet e ndryshme, tha z. Bislimi. Lidhur me këtë tha se ka takuar OJQ të ndryshme, që kanë qenë aktive në dialog, të cilat kanë pasur dokumente, dhe se është takuar edhe me ish- negociatorët, ose personat që kanë qenë të përfshirë nëpër negociata siç janë z. Veton Surroi, z. Blerim Shala dhe z. Skënder Hyseni, kurse znj. Edita Tahiri ka refuzuar të takohet. Njoftoi për dosjet e dokumenteve që ia ka dhënë atij z. Lajçak, me përafërsisht 200-300 faqe, ndërsa dokumenti tjetër, i cili i është dorëzuar nga qeveria e kaluar për tërë ecurinë e dialogut, tha se në të nuk ka asgjë konkrete, nuk ka substancë dhe ka vetëm disa qëndrime të ekspertëve të kyçur për një temë të caktuar. Një prej arsyeve që kanë shkuar në Bruksel tha se është se z. Lajçak ka qenë i gatshëm ta dorëzojë të gjithë dokumentacionin që ai e ka dhe të informojë shkurtimisht për çdo gjë që ka ndodhur. Bëri të ditur përbërjen e delegacionit të Kosovës në takimet e datës 27 prill me z. Lajçak, si dhe përbërjen e delegacionit të z. Lajçak të cilët janë ndërruar varësisht nga tema e takimit. Fillimisht znj. Ana Maria Bauer tha se ka prezantuar për gjithë ecurinë e dialogut para marrjes së detyrës nga ana e z. Lajçak dhe pastaj z. Lajçak për pjesën tjetër të bisedimeve pas marrjes së mandatit.

Haki Abazi, në bazë të asaj që z. Bislimi ka marr si informacion nga z. Lajçak në temat e ndryshme përfshirë edhe për të ashtuquajturën marrëveshjen e madhe për Asociacionin e komunave me shumicë serbe, kërkoi të dijë se ku qëndron Republika e Kosovës në këtë situatë, si dhe në raportin me BE-në. Lidhur me znj. Ana Maria Bauer, tha se ajo në një deklaratë të e saj publike ka thënë se Kosova është e obliguar që të krijoj pushtetin e tretë për ta akomoduar Asociacionin e komunave me shumicë serbe. Kërkoi të dijë nëse znj. Bauer gjatë referimit të saj, e ka përmendur dhe rikonfirmuar të njëjtën çështje. Kjo çështje tha se është pajtuar në ish delegacionin e atëhershëm ku ka bërë pjesë edhe z. Blerim Shala.

Besnik Bislimi, lidhur me deklaratat e znj. Bauer, tha se nuk i ka analizuar deklaratat që i ka dhënë më herët dhe se gjatë vizitës në Bruksel ajo vetëm ka raportuar se çfarë ka ndodhur pas miratimit të rezolutës në Kombet e Bashkuara në shtator 2010 dhe fillimit të punës në Bruksel në pika shumë të shkurtra. Sa i përket pyetjes se ku gjendemi në dialog, tha se kjo tejkalon raportimin nga vizita, dhe kërkon që për këtë pjesë seanca të jetë e mbyllur.

Haki Abazi tha se deklarata publike nuk është çështje opinionesh, dhe kërkoi të dijë nëse znj. Bauer ka thënë se është pranuar Asociacioni me kompetenca ekzekutive gjatë reflektimit se çfarë ka ndodhur në të kaluarën.

Besnik Bislimi tha se ajo nuk ka dhënë kurrfarë opinionin të saj, ka shpjeguar ecurinë se si është arritur marrëveshja e parë, e dyta dhe se nuk ka folur as për kompetenca as për mungesë të kompetencave. Asociacioni është shpjeguar nga një prej anëtarëve të stafit të z. Lajçak në 15 minutat e fundit të takimit të dytë.

Time Kadrijaj tha se materiali që është dërguar nga zëvendëskryeministri është dashur t'i shpërndahet edhe deputetëve, sepse është praktikë që kur ministrat vijnë të raportojnë paraprakisht dërgojnë material që deputetët të shërbehen për të diskutuar. Sa i përket mbylljes së seancës, tha se ne mund ta fillojmë si seancë të hapur në mënyrë që edhe opinionin të informohet për temat që janë të rëndësishme së veçantë dhe më pas për temat për të cilat mendoni se nuk duhet të jenë për opinionin mund ta mbyllim seancën.

Haki Abazi, lidhur me materialin, njoftoi se ka ardhur sot, para 15 minutave, të cilin do t'ua shpërndajë anëtarëve të komisionit.

Xhavit Haliti, pyeti z. Bislimin se a është drejtues i bisedimeve i caktuar nga qeveria, apo ka shkuar në Bruksel për ta zëvendësuar Kryeministrin, sepse përgjegjësinë politike kryesore duhet ta ketë një person. Ajo çfarë kemi dëgjuar nga Kryeministri tha se është se nuk ka filluar dialogu dhe se takimet e para do të fillojnë në qershor dhe lidhur me këtë pyeti se cilat janë temat që do të diskutohen dhe kur do të fillojë dialogu.

Ariana Musliu-Shoshi, shprehu mendimin se ftesa që i është bërë z. Bislimi është dashur t'i dorëzohet edhe znj. Gërvalla, pasi ajo është përgjegjëse të që raportojë në këtë komision. Sa i përket raportit që e ka dorëzuar zëvendëskryeministri, ajo tha se nga z. Enver Hoxhaj nuk është pranuar asnjë raport deri më tani. Duke iu referuar raportimit të z. Bislimi se vizita nuk ka qenë për dialog, ajo tha se kjo vizitë është për dialog, ftesa ka qenë për dialog dhe se kjo ka qenë një vizitë jo transparente, sepse në të gjithë "tweet" që ju i keni pas, është anashkaluar dialogu, mirëpo në të gjithë "tweet" nga personat që ju i keni takuar përfshirë edhe z. Lajçak ka qenë që dialogu ka qenë pikë e diskutimit. Ajo shtoi se detyra e z. Lajçak është që të marrë qëndrimin e secilës palë, gjë që nuk kemi, nuk kemi as qëndrim, as plan, e as informatë se cilat janë temat të cilat ju do t'i diskutoni. Më tej pyeti se a qëndroni prapa të gjithë atyre temave që keni qenë kundër që nga dita e parë kur është folur për dialogun.

Haki Abazi, lidhur me ftesën drejtuar znj. Gërvalla, njoftoi se ministrja do ta ftohet në një moment tjetër, pasi që komisioni e ka në plan që ta ftojë ministren në raportim.

Gazmend Gjyshinca, tha se është një prej shenjave të mira për një qeverisje të mirë fakti që zëvendëskryeministri raporton para komisionit, është shenjë që ka filluar një periudhë e re në mënyrën se si do të trajtohen këto tema. Pyeti z. Bislimi se a mund ta informojë komisionin për natyrën e informacionit që e ka marrë nga z. Lajçak dhe se çfarë përmban ky informacion, se me cilët komisionarë është takuar dhe për cilat tema kanë diskutuar; si dhe për situatën e fundit në lidhje me liberalizimin e vizave, ku qëndron problemi, dhe si e sheh klimën brenda BE-së sidomos pas ndërrimit të pushtetit në Kosovë.

Besnik Bislimi, sa i përket raportit me shkrim, sqaroi se vizita ka përfunduar të enjten në mbrëmje, kurse të premten ka qenë në Kosovë dhe rrjedhimisht nuk ka mundur të vijë me raport të gatshëm. Dokumenti tha se nuk është publik për t'i informuar deputetët, raporti me shkrim është pjesë e obligimit që ka marrë ai, që për çdo rund të bisedimeve t'i informojë personat kyç të jetës politike në Kosovë.

Xhavit Haliti tha se secili anëtar i komisionit e ka rëndësinë e tij, se i kanë qëndrimet e veta individuale, por edhe ato të partive. Ai bëri të ditur se nuk kërkon nga askush, as nga kryetari i partisë ta informojë për çështjet që është obligim i z. Bislimi. Pyeti se z. Bislimi se a është nëpunës i Kryeministrit, i ngarkuar për të kryer detyra teknike apo ka përgjegjësi politike dhe kompetenca të plota për të vendosur dhe nënshkruar në emër të Kosovës.

Besnik Bislimi, lidhur me fillimin e dialogut, bëri të ditur se Kryeministri ka thënë se nuk kanë filluar bisedimet dhe se ato do të fillojnë në qershor. Gjatë vizitës në Bruksel tha se ka pasur vetëm raportim të z. Lajçak për ecurinë e bisedimeve të deritanishme dhe jo bisedime. Bisedime tha se nuk do të kemi me BE-në, bisedimet do t'i zhvillojmë me palën serbe. Nuk do të ketë takime dhe bisedime para pjesës së dytë të qershorit. Duke iu referuar pyetjes së deputetes Musliu-Shoshi lidhur me mos prezencën e ministres Gërvalla, tha se ky raportim është ftuar për punën dhe takimet që i ka pasur me z. Lajçak, më 27 prill 2021, ku znj. Gërvalla nuk ka qenë prezente. Takimet ku ka qenë prezente znj. Gërvalla dhe ku janë përmendur çështje indirekte të ecurisë së deritanishme të dialogut, ka qenë darka me z. Lajçak më 28 prill dhe dreka me z. Borel më 29 prill. Sa i përket mungesës së dokumentacionit, z. Bislimi shtoi se do të ishte shumë më mirë që këto dokumente t'i kishte pranuar nga z. Hoti, z. Haradinaj e z. Thaçi.

Time Kadrijaj, lidhur me mungesën e dokumentacionit, tha se kjo nuk qëndron, pasi që me pranim-dorëzimin e detyrës, dorëzohen të gjitha materialet. Z. Hoti, si dhe ish kryeministrat tjerë kanë thënë se dokumentacioni mbetet në zyre të Kryeministrit, ato dokumentacione, secili dikaster i ka dhe është marrë të thuhet se nuk kemi gjetur asgjë dhe se keni qenë të detyruar të shkoni në Bruksel për të marrë informacione. Çdo herë që ka shkuar Kryeministri, apo çdokush që ka shkuar në Bruksel, kanë ardhur dhe kanë raportuar dhe kërkon të dijë se çfarë është diskutuar në Bruksel.

Besnik Bislimi njoftoi se kur z. Hoti e ka dorëzuar dokumentacionin, ai e ka dorëzuar edhe listën e dokumentacionit që e ka dorëzuar dhe aty vërehet se vetëm këto janë. Në raportin e dorëzimit shkruan se këto janë dokumentet që i ka dorëzuar z. Hoti. Nëse i jepet peshë më shumë deklaratës së Lajçakut, atëherë duhet të ftohet ai që të raportojë. Sa i përket pyetjeve të deputetit Gjyshinca se çfarë përmban dokumentacioni i Lajçakut, tha se ai përmban pothuajse të gjitha marrëveshjet që janë bërë deri më tani, përmban përkrahjet e marrëveshjeve, press statement për marrëveshjet, qëndrimet e palëve. Dokumentacioni tha se nuk e përmban dinamikën e bisedimeve, nuk i përmban

ndryshimet nga drafti i parë në atë të dytin e tretin, për ta parë se si kanë lëvizur palët nga qëndrimet e tyre fillestare deri në fund. Lidhur me takimet me komisionarë ai njoftoi se janë takuar me z. Janusz Wojciechowski, komisionar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, me komisionarin për Drejtësi z. Didier Reynders, komisioneren për Energji, znj. Kadri Simson, komisionerin për Çështje Ekonomike dhe Financiare, z. Paolo Gentiloni, si dhe komisionarin për Fqinjësi të Mirë dhe Zgjerim z. Olivér Várhelyi. z. Bislimi më tej njoftoi për temat që ka diskutuar me komisionarët ku tema e vaksinës dhe e menaxhimit të pandemisë që ka qenë temë fillestare me secilin komisionarë, pastaj janë diskutuar çështje specifike. Brenga kryesore të liberalizimi i vizave tha se është që dy shtete kanë bregat e tyre ato janë Franca dhe Holanda, mirëpo jo zyrtarisht na është thënë se duhet të punojmë më shumë edhe me Danimarkën dhe Belgjikën, për arsye se potencialisht edhe këto vende mund të kundërshtojnë edhe pse nuk e kanë thënë këtë publikisht.

Gazmend Gjyshinca, pyeti se a është përmendur, apo a i janë referuar ndonjë periudhe kohore se kur do të mund të lëviznin gjërat në këtë drejtim.

Besnik Bislimi tha se brenda BE-së Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian janë plotësisht dakord, problemi është te Këshilli i ministrave. Mekanizmi që lidhet me përgatitjen e agjendës, e ka të pamundur ta vendosë në agjendë çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën, përderisa nuk zgjidhet dilema e Francës.

Time Kadrijaj pyeti zëvendëskryeministrin se a do të kërkohet të mbahet dialog teknik apo politik dhe se a do të bëhen transparente agjendat e dialogut, sepse ne nuk kemi qenë të informuar se cila ka qenë agjenda e takimeve. Ajo në vazhdim pyeti se z. Bislimin se çka mendon, se mund të mendoj BE për liberalizimin e vizave, përderisa Presidentja dhe ministrja e Jashtme në organizata të ndryshme e në Këshill të Sigurimit flasin për krimin dhe korrupsionin në Kosovë. Pas theksimit të zëvendëskryeministrit, se Kosova i ka përmbushur kushtet për liberalizimin e vizave e po ashtu edhe Parlamenti Evropian ka dhënë sinjal pozitiv për liberalizim të vizave tha se kriteri i krimit dhe korrupsionit nuk është kriter që përmbillet, por ai në vazhdimësi duhet të luftohet. Znj. Kadrijaj po ashtu pyeti se cili është plani i dialogut e i dinamizmit të tij, cilat janë parimet e dialogut, çka do të lejohet të dialogohet e çka jo dhe a do të ketë angazhime që në këtë proces të përfshihet edhe Amerika.

Ariana Musliu-Shoshi, lidhur me raportimin e zëvendëskryeministrit, tha se deri tani u njoftuam vetëm për çështje teknike dhe nuk morëm asnjë informatë esenciale. Ajo ju drejtua zëvendëskryeministrit se në vazhdimësi kanë kërkuar që në këtë proces të jenë Lajçaku e Borelli të cilët nuk e njohin pavarësinë e Kosovës dhe e shmangin realitetin politik në Kosovë. Përkrahu angazhimin e ekspertëve në këtë proces duke potencuar se ata kanë një memorie institucionale dhe mund të informojnë për çështjet të cilat kanë ndodhur nëpër këto takime. BE tha se kërkon, normalizim të marrëdhënieve, asociacionin me kompetenca të ekzekutive dhe implementim të marrëveshjeve, pyeti se a është diskutuar për njohjen finale reciproke. Sipas komunikatës së BPRG-së të dt. 26 prill thuhet se duhet respektuar Marrëveshja e Uashingtonit, ndërsa z. Kurti në një prononcim ka thënë se nuk do të respektohen zotimet e qeverisë së kaluar, cili është zotimi që keni marrë në Bruksel lidhur me këtë marrëveshje. Theksoi se pasi nuk kemi plan të qeverisë, në prioritetë është paraparë rikthimi i adresës politike të Kosovës drejt BE-së, konkretisht kthimi i Ministrisë së Integritetit, pyeti se çka do të ndodhë me këtë.

Besnik Bislimi, duke u përgjigjur në pyetjet e deputetëve, bëri të ditur se në bisedime nuk do të fillohet me dialog teknik. Njoftoi se është i autorizuar nga kryeministri Kurti që të udhëheq dialogun me Serbinë dhe ai i dikton objektivat, ndërsa për nga instrumentet është i pavarur dhe se kur mendon se një informatë e rrezikon objektivin e bisedimeve nuk e publikon atë. Se çka mendon BE për liberalizimin e vizave, tha se duhet pyetur BE-në, ndërsa sa i përket vendimeve të BE-së ata i nxjerrin vendimet bazuar në raportime e jo në bazë të deklaratave tona politike. Lidhur me planin dhe parimet e dialogut z. Bislimi tha se është arritur dakordimi që të ketë bisedime për arritjen e një marrëveshjeje të përgjithshme mes dy shteteve e cila është ligjrisht e obligueshme, çështje e cila mund të diskutohet në takim të mbyllur. Më pas theksoi se prioriteti i qeverisë së Kosovës është drejtësia, punësimi, ringjallja nga pandemia, edukimi, ambienti, ndërsa zëvendëskryeministri i cili nuk ka asnjë portofol merret me çështjen e dialogut, gjë që z. Kurti e ka potencuar qartë se qeveria e tij ka me qenë me prioritetet e brendshme dhe zëvendëskryetari i parë, nënkryetari i partisë merret me dialogun. Z. Bislimi njoftoi se në Bruksel nuk është biseduar për marrëveshjen në SHBA, në asnjërin takim.

Haki Abazi, pyeti z. Bislimin se a është duke u punuar në platformën e re për dialogun me Serbinë, nëse po në cilën fazë jemi dhe kush është i përfshirë në përgatitjen e platformës. Ai po ashtu pyeti zv. kryeministrin se nëse mund të informojë për marrëveshjen e nënshkruar me ambasadën norvegjeze për asistencën e qeverisë nga një organizatë joqeveritare dhe për disa ekspertë dhe rolin e tyre në procesin e dialogut, se në çfarë kritere është bazuar përzgjedhja e organizatës jo qeveritare dhe ekspertëve në raport me dialogun dhe për nevojat e ndryshimit të platformës krahasuar me atë të kaluarën.

Besnik Bislimi, njoftoi se sipas parimeve të qeverisë Kurti, marrëveshjet nuk do të rinegociohen, nuk krijohet shtresë e re e qeverisjes në Kosovë, nuk preket sovraniteti territorial dhe nuk diskutohen çështje të brendshme të Kosovës. Nuk ka marrëveshje me Serbinë pa qenë brenda njohja nga 5 vendet e BE-së dhe garancinë për anëtarësim nga OKB. Në platformë nuk kyçen ekspertë nga jashtë, platforma për dialogun përpilohet nga z. Kurti dhe z. Bislimi. Marrëveshja me Ambasadën e Norvegjisë tha se është nënshkruar në shtator të vitit të kaluar nga z. Hoti dhe ambasadori norvegjez, ku Ambasada e Norvegjisë ka alokuar një fond të caktuar të mjeteve për akomodim të ekspertëve që ta ndihmojnë ekipin negociator. BPRG nuk ka kurrfarë kompetence mbi grupin e ekspertëve. Bëri të ditur se në shtyllën I të diplomacisë janë angazhuar dy ekspertë z. L. Malazogu dhe z. B. Nikaj, në shtyllën II akademike janë angazhuar prof. Z. M. Mustafa dhe z. R. Muharremi dhe me kërkesë të tij është shtuar edhe shtylla III me njerëz të cilët për nga roli i tyre në të kaluarën kanë informata për momente të caktuara dhe në këtë kontest është angazhuar z. V. Surroi dhe z. B. Shala, të cilët kanë informata për të cilat mungon memoria institucionale dhe shtylla IV që pritet t'i shtohet këtij grupi janë ekspertët ndërkombëtar të cilët janë marrë me dialogun apo janë ekspertë në këtë drejtim, por në asnjë moment nuk janë anëtarë të ekipit negociator. Njoftoi se negociatat në BE zhvillohen në formatin 1+1 dhe se autorizimin për nënshkrimin e tyre e ka vetëm z. Kurti.

Haki Abazi, duke u ndërlidhur me njoftimet nga z. Bislimi pyeti se, kush e ka bërë përzgjedhjen e individëve në grupet dhe shtyllat, ambasada norvegjeze, organizata joqeveritare apo qeveria.

Besnik Bislimi, tha se nuk e di si ka qenë përzgjedhja më herët për këtë duhet të pyetet BPRG, ndërsa njoftoi se ai ka propozuar të shtohen edhe dy shtylla me këshilltar ndërkombëtar dhe ata të

cilët e njohin procesin e negociatave nga brenda për të cilat nuk ka dokumentacion të shkruar. Njoftoi se edhe Ambasada Hungareze ka vendosur ta sjellë një ekspert me eksperiencë në BPRG, Ambasada e Zvicrës është duke punuar që ta sjellë një ekspert të dialogut e po ashtu Ambasada e Britanisë së Madhe ka një këshilltar i cili merret me çështje të dialogut dhe pritet që këtij ekipi t'i shtohen edhe emra të tjerë.

Haki Abazi tha se emrat e përmendur më lart, kanë qenë në një fazë ose tjetër pjesë e diplomacisë dhe pjesë e negociatave e dialogut dhe sipas konkludimit tuaj se nuk janë gjetur të shkruara proceset sidomos që z. Shala ka qenë në mënyrë konsistente nëpër procese, a nuk i bie faji edhe z. Shalës për mungesë të përshkrimit të dinamikës së procesit të dialogut, por edhe të tjerëve. Sa i përket marrëveshjes për të cilën z. Bislimi tha se është nënshkruar nga z. Hoti dhe Ambasada e Norvegjisë, tha se në fakt i është referuar marrëveshjes së nënshkruar në mes z. Kurtit, ambasadorit norvegjez dhe përfaqësuesit të organizatës jo qeveritare, të cilën marrëveshje kërkoi që në mënyrë zyrtare t'i përcillet komisionit.

Time Kadrijaj, lidhur me platformën për dialogun, tha se duhet të ketë një debat dhe një gjithë përfshirje. Sa i përket të pagjeturve theksoi se LVV gjithnjë ka thënë se nuk do të dialogoj përderisa të mos kthehet edhe i pagjeturi i fundit, pyeti se cila do të jetë qasja për të pagjeturit në dialogun që po zhvillohet. Po ashtu pyeti se, a do t'i rishqyrtojnë të gjitha marrëveshjet që janë arritur në Bruksel, se a është negociua tani lidhur me Asociacionin e komunave me shumicë serbe dhe cili është qëndrimi i qeverisë.

Xhavit Haliti theksoi se puna e qeverisë në dialog me Serbinë është tepër e rëndësishme dhe duhet pasur kujdes në strategjinë, sepse kanë qëndrim konsistent të cilin është vështirë për ta ndryshuar. Serbia po insiston me çdo kusht që Kosova të vazhdojë të jetë pjesë e Rezolutës 1244 dhe kjo rezolutë të mos ndryshohet, dhe të bëjnë përpjekje për ta rikthye Kosovën nën sundimin e tyre. Ai tha se është problem i madh që në KS të ndryshohet Rezoluta 1244 në këto rrethana pasi që Rusia e Kina nuk janë dakord, por duhet parë një variant të mundshëm për ta hequr këtë rezolutë. Ai theksoi se duhet ndërtuar një strategji të përbashkët me aleatë pa të cilët ne nuk do të mund të ishim në këto institucione ku jemi sot. Ne të gjithë jemi të zgjedhur dhe të gjithë kemi preokupim zgjidhjen e problemit të Kosovës dhe duhet të krijojmë një politikë shtetërore, të cilën deri më tani nuk arritëm ta krijojmë. Z. Haliti po ashtu tha se duhet shikuar që të bëjmë nisma me delegacionet e shteteve të Parlamentit Evropian në mënyrë që nxirret në votim liberalizimi i vizave.

Besnik Bislimi, duke u ndërlidhur me çështjet e ngritura nga anëtarët e komisionit, tha se nuk do të merret me atë se kujt do t'i mbetet faji dhe çfarë përgjegjësie do të marrin për procesin e negociatave sepse është jashtë angazhimit të tij por do të angazhohet që të merr sa më shumë informata që janë të rëndësishme dhe do të bashkëpunoj me secilin që ka informata.

Haki Abazi tha se ai e shtroi çështjen për atë se a mund të priten rezultate tjera nga njerëzit që për 11 vite kanë udhëhequr dhe kanë qenë pjesë e trurit teknik të dialogut, për të cilin kemi qëndrim se ka shkuar në drejtim të gabuar.

Besnik Bislimi, theksoi se marrëveshja është nënshkruar nga z. Hoti, ndërsa nga z. Kurti është amendamentuar marrëveshja për komponentët, eksponent ndërkombëtar dhe këshilltarë shtesë. Bëri të ditur se fondi i ambasadës norvegjeze është i mjaftueshëm për angazhim të 2 apo 3 fisht të

ekspertëve përtej numrit të pranishëm dhe se nuk mund të angazhohen militantë partiak. Z. Bislimi shprehu gatishmërinë që të takohet me çdo kë që ka ndonjë ide, në momente kur shihet e dobishme që të ndahet me të. Ai theksoi se pajtohet me znj. Kadrijaj që platforma duhet të ketë debat dhe gjithë përfshirje dhe të gjitha informatat t'i grumbullojmë dhe ta shkruajmë platformën e cila bëhet pjesë e strategjisë së grupit negociator.

Komisioni, pas nevojës për diskutimin me zëvendëskryeministrin për çështje më të ndjeshme, vendosi që raportimi të vazhdojë me dyer të mbyllura për publikun.

Pas përfundimit të raportimit nga zëvendëskryeministri, komisioni vazhdoi punën me pikat e mbetura të rendit të ditës.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13 prill 2021

Kryetari konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13 prill 2021.

4. Miratimi i fushëveprimit të komisionit;

Haki Abazi, i njoftoi anëtarët e komisionit se sipas vendimit nr. 08-V-006 të seancës plenare të datës 2 prill 2021 për formimin e komisioneve parlamentare është kërkuar që fushëveprimi i komisioneve të harmonizohet me vendimin e seancës.

Ai kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen lidhur me fushëveprimin e komisionit.

Pas diskutimeve, kryetari i Komisionit konstatoi se komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni miratoi fushëveprimin e punës si vijon:

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë është Komision Funkcional.

Komisioni, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësive, e ndërton bashkëpunimin me parlamentet e shteteve dhe e promovon anëtarësimin e Kuvendit në organizatat parlamentare rajonale e ndërkombëtare, si dhe i shqyrton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me diasporën. Fushëveprimi i këtij Komisioni përfshin:

- Në koordinim me Kryetarin dhe me Kryesinë e Kuvendit, bën ndërtimin e bashkëpunimit me parlamentet e shteteve dhe e promovon anëtarësimin e Kuvendit në organizatat parlamentare rajonale e ndërkombëtare;
- Shoqërimin e Kryetarit të Kuvendit në takimet parlamentare ndërkombëtare;

- Ratifikimin në bllok ose ndaras të traktateve ekzistuese, të cilat Kosova dëshiron t'i nënshkruajë;
- Përcjelljen e negociatave të udhëhequra nga Qeveria për bashkëpjesëmarrje të saj në traktatet e reja dhe e nis debatin për ratifikimin e tyre;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve për punë të jashtme, diasporë dhe për imunitetet diplomatike;
- Mbikëqyrjen e veprimeve të Qeverisë në planin e politikës së jashtme dhe të diasporës;
- Shoqërimin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe Diasporës në takime të caktuara, të rëndësishme;
- Bashkëpunimin me komisionet homologe të parlamenteve të vendeve të tjera;
- Promovimin e diplomacisë parlamentare të Kuvendit;
- Shqyrtimin e projektligjeve të propozuara nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës;
- Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së resorit përkatës dhe i rekomandon Komisionit për Buxhet, shqyrtimin dhe miratimin e tij në Kuvend, duke i përfshirë edhe amendamentet;
- Shqyrtimin e çështjeve të tjera, të përcaktuara me këtë Rregullore dhe të çështjeve, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

Në ushtrimin e funksioneve, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës, me rrjetin diplomatik të Kosovës dhe me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni.

5. Shqyrtimi i përfundimit nr. 08-P-007 lidhur me formimin e grupeve të miqësisë

Haki Abazi njoftoi anëtarët e komisionit se sipas Përfundimit nr. 08-P-007 lidhur me formimin e grupeve të miqësisë nga Kryetari i Kuvendit, i është kërkuar Komisioni të përgatitë propozim vendimin për numrin dhe përbërjen e grupeve të miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit tonë me deputetët e parlamenteve të shteteve të tjera.

Ai shtoi se kemi një propozim nga legjislatura e kaluar, i cili përmban formimin e grupeve të miqësisë me 56 shtete, si dhe ka përbërjen e anëtarëve të grupit të miqësisë kryesisht nga legjislatura e kaluar.

Anëtarët e komisionit diskutuan lidhur me formimin e grupeve të miqësisë, të cilët u shprehën se përbërja e grupeve të miqësisë duhet të përcillet nëpër grupe parlamentare në mënyrë që të propozohen deputetët anëtarë të grupeve të miqësisë, sipas shprehjes së vullnetit të tyre politik.

Në takim po ashtu u propozua që komisioni të ketë parasysh formimin e një grupi punues për shqyrtimin e mundësisë së nxjerrjes së Rregullores së re për grupet e miqësisë nga fakti se Rregullorja ekzistuese është miratuar në vitin 2009, dhe se është e nevojshme të bëhen ndryshime.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se komisioni nxori këtë

Përfundim

Të kërkohet nga grupet parlamentare propozimi i anëtarëve për emërime në grupet e miqësisë e më pas komisioni t'i rekomandojë Kryesisë miratimin e propozimin për formimin e grupeve të miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe parlamentarëve të shteteve të tjera.

6. Të ndryshme

Komisioni vendosi që të martën më 11 maj 2021, nga orën 10:00 të ftojë ministren e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të raportojë lidhur Planin legjislativ të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetar i komisionit,

Haki Abazi